

EDUINO WEBINAR

Faqja fillestare EDUINO WEBINARË 2022

Çfarë janë EDUINO webinarët?

EDUINO-webinarët janë evenimente joformale interaktive, ku pjesëmarrësit kanë mundësi të ndjekin ligjerata për tema aktuale, inovative dhe të avancuara nga sfera e arsimit, përmes shembujve të praktikave dhe këshillave të mira nga kolegët e tyre praktikues.

Evenimentet janë krijuar për të ofruar mundësinë për të bërë pyetje dhe për t'u konsultuar me ligjëruesit për forma, metoda, teknika dhe instrumente të caktuara për zhvillimin e procesit të të mësuarit dhe mësimdhënies në mësimdhënien moderne. Seria EDUINO Webinare sot përmban burimet më të njohura në internet për përvetësimin e aftësive në fushën e arsimit dhe janë online webinarët më të shikuara sipas statistikave tona. Nëpërmjet këtij lloji të evenimenteve interaktive dhe joformale kemi mundësinë të ndikojmë drejtpërdrejt në zhvillimin profesional dhe avancimin e aftësive dixhitale të shumë edukatorëve në vendin tonë.

Çfarë ka të re?

Një numër i konsiderueshëm prej 18.000 pjesëmarrësve që e kanë ndjekur edicionin e parë të serisë gjatë vitit të kaluar, na inkurajoi që edhe këtë vit t'u përgjigjemi nevojave dhe sfidave të edukatorëve.

Përmes serisë EDUINO-webinarë 2022, pjesëmarrësit do të mund ta përmirësojnë zhvillimin e tyre personal dhe profesional si edukatorë, duke fituar njohuri nga kolegët e tyre, ligjërues me renome, secili në fushat e tyre. Dëgjuesit në këto webinarë do të fitojnë njohuri të ndryshme, që do të kenë mundësi t'i tregojnë dhe ti ndajnë me të tjerët.

Në pjesën e parë (maj 2022) të kësaj serie, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të marrin një lloj certifikati, që është certifikat për njohuritë e fituara. Ndërsa në pjesën e dytë të serisë (shtator 2022) pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të përfitojnë dy lloje certifikatash: njohuritë e fituara dhe të aplikuar.

Seria EDUINO Webinarë 2022, do të jetë në dispozicion në dy faza edhe atë maj dhe shtator 2022. Në fazën e parë, maj 2022, shpallim katër webinarë me tre tema të ndryshme (një temë do të trajtohet në maqedonisht dhe shqip), ndërsa webinarët e tjera do të mbahet në shtator 2022. Ajo që është një risi veçanërisht e rëndësishme është se EDUINO Webinarët kanë zgjeruar ekipin e tyre duke prezantuar interpretues simultan

EDUINO WEBINAR

në secilin prej webinareve, në mënyrë që webinarët të mund të ndiqen në gjuhën maqedone dhe shqipe. Gjithashtu, siç e përmendëm, do të mbahet një webinar i veçantë në dy gjuhë, në gjuhën maqedone dhe shqipe.

Si të marrim certifikata për njohuritë e fituara?

Të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar kanë mundësi të marrin një certifikatë për njohuritë e fituara, pavarësisht a e ndjekin webinarin përmes platformës zoom apo Youtube live.

Menjëherë pas përfundimit të webinarit, duke shpërndarë një link nga Google forms, do të hapet një kuiz me dhjetë (10) pyetje dhe do të jetë në dispozicion të pjesëmarrësve. Për marrjen e certifikatës është e nevojshme:

- të përgjigjeni saktë në të paktën shtatë nga dhjetë pyetjet e parashtruara (ose 70%).

Theksojmë se kuizi është i hapur për zgjidhje në afat kohor prej 15 minuta sipas njoftimit të moderatorit, pas mbarimit të kohës së paraparë kuizi mbyllet nga ana e ekipit teknik.

Nëse plotësoni kushtin e mësipërm për marrjen e një certifikati, i njejt i do t'ju dërgohet në adresën e emailit të cilën do ta vendosni kur përgjigjeni në kuizin brenda dy deri në tre javë nga ekipi teknik i EDUINO.

1. Ku mund ta gjej link-un e kuizit?

Link-un e kuizit mund ta gjeni në www.eduino.mk në pjesën për webinarin të cilit i referohet kuizit. Gjithashtu nëse ndiqni webinarin në YouTube, mund ta gjeni link-un në përshkrimin poshtë videos. Ju tërheqim vërejtje se lidhja është aktive vetëm 15 minuta pas përfundimit të webinarit.

EDUINO WEBINAR

2. Si të hyni në menti meter?

Gjatë webinarit moderatori do t'ju japë udhëzime për t'u përfshirë në menti meter. Duhet të futni www.menti.com në veglën kërkuese tuaj dhe më pas të vendosni kodin që do të shfaqet në ekranin e ndarë nga moderatori.

3. Sa zgjatë kvizi për njohuritë e fituara?

Në fund të webinarit, pas shenjës së fillimit të dhënë nga moderatori, nis kuizi i cili do të jetë i hapur 15 minuta. Nëse keni probleme me fillimin e kuizit, atëherë provoni të bëni refresh faqen.

4. Pse ndonjëri ndjek webinarin përmes Zoom ndërsa tjetri ndjek përmes YouTube?

Për shkak të aksesit teknikisht të kufizuar në platformën Zoom, nga 500 pjesëmarrës gjithsej, disa prej pjesëmarrësve duhet të ndjekin webinarët përmes kanalit të EDUINO në YouTube live. Prandaj, monitorimi nga të dyja platformat ka të njëjtat privilegje dhe vlerësohet njësoj.

5. Si mund të parashtroj pyetje gjatë webinarit?

Gjatë webinarit, moderatori do të fillojë një seancë pyetje-përgjigje brenda temës së webinarit në menti meter (www.menti.com). Në atë moment ju mund të bëni pyetjen tuaj në lidhje me temën dhe do të merrni përgjigje nga ligjeruesi.

6. Kur dhe në çfarë forme e fitoj certifikatin?

Nëse i keni përfunduar me sukses aktivitetet e dhëna (kuizi dhe/ose aktivitet të realizuar) do ta merrni certifikatën në dy-tre javët e ardhshme. Certifikatat e dhëna do të jenë në formë digjitale të nënshkuara dhe vulosura nga drejtori i Byrosë për zhvillimin e arsimit (BZHA).

EDUINO WEBINAR

7. A do të dëgjohen të gjithë webinarët në gjuhën maqedonase dhe shqipe?

Po, të gjithë webinarët kanë një interpretues simultan nga maqedonishtja në shqip.

8. Kur mbahet webinarin, i cili do të jetë në gjuhën maqedone dhe shqipe?

Webinari që do të mbahet më 17.05.2022 do të jetë EDUINO Webinar në gjuhën maqedone, ndërsa e njëjta temë do të ligjerohet tërësisht në gjuhën shqipe më 19.05.2022. Të gjitha temat dhe datat e mbetura janë Webinare, ligjëruesit e të cilëve flasin maqedonisht, dhe ofrohet një interpretues simultan në gjuhën shqipe.

9. Si të aktivizoj interpretuesin simultan? - [Link](#)

Të gjithë pjesëmarrësit që do të ndjekin Webinarët EDUINO në gjuhën maqedone, do të mund t'i ndjekin ato me interpretues simultan në gjuhën shqipe, si më poshtë:

- Nëpërmjet platformës ZOOM, ata do të kenë mundësinë të zgjedhin drejtpërdrejt gjuhën e duhur në të cilën duan të dëgjojnë webinarin.
- Përmes platformës YouTube do të ketë dy link-a të veçanta për t'u qasur në webinarin, përkatësisht: një link për ndjekjen e webinarit në gjuhën maqedone dhe një link për ndjekjen e webinarit në gjuhën shqipe.